

Ndikimi i diasporës në ekonominë e Kosovës gjatë pandemisë COVID-19

Arritjet

12:00	Motra me familje	Anuluar
12:07	Gjyshja prej Gjermanisë	Anuluar
12:12	Babi	Anuluar
12:25	Djent e Axhës	Anuluar
12:26	Qikat e Mallës	Anuluar
12:40	Djali me tika	Anuluar
12:55	Daja prej Amerikës	Anuluar
13:03	Nifat	Ar
13:08	Djent e Tezës	Ar
13:17	Axha prej Zvicrës	F
13:30	Tezja	
13:33	Qika e Dajës	

Ndikimi i diasporës në ekonominë e Kosovës gjatë pandemisë COVID-19

Nëntor 2020

Përmbajtja

1. Hyrje	4
2. Kufizimet e hyrjeve në Kosovë gjatë pandemisë COVID-19	5
3. Kufizimet e lëvizjes ndër-shetërore të vendosura nga vendet ku jeton shumica e diasporës kosovare	7
4. Rënia e të hyrave në ekonomi nga mos ardhja e diasporës në Kosovë	9
5. Remitencat e diasporës gjatë pandemisë	12
5.1 Faktorët që ndikojnë në lartësinë e remitencave	12
6. Diaspora dhe Investimet e Huaja Direkte (IHD) në Kosovë	15
7. Politika që nxisin shfrytëzimin e qëndrueshëm të kapitalit financiar dhe njerëzor të diasporës për zhvillim ekonomik	17
7.1 Shfrytëzim i qëndrueshëm i kapitalit financiar të diasporës	17
7.2 Shfrytëzimi i kapitalit njerëzor të diasporës	18
8. Përfundime dhe rekomandime	19
9. Aneksset	20

Deklaratë mohimi:

Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim janë të Institutit GAP dhe jo domosdoshmërisht konsiderohen si qëndrim i Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur

Originali është shkruar në shqip

Ky publikim është mbështetur nga:

Përmbledhje ekzekutive

Në kohë kur ekonomia e Kosovës po pëson rënie si pasojë e pandemisë së shkaktuar nga COVID-19, roli i diasporës në ekonominë e Kosovës vazhdon të jetë tejet i madh. Diaspora ka ndikim në ekonominë e Kosovës qoftë përmes remitencave, investimeve të huaja direkte (IHD), dërgimit të gjësendeve për familjet e tyre apo edhe përmes shpenzimeve që i bëjnë gjatë vizitave në Kosovë. Në kushte jashtë pandemie, më shumë se gjysma e diasporës realizon tri deri në katër vizita gjatë vitit në Kosovë, ku qëndrimi zgjat nga dy deri në katër javë, duke realizuar shpenzime qindra milionëshe me vlerë deri në rreth 4.6% të Bruto Produktit Vendor (BPV). Përderisa roli i remitencave të diasporës në ekonominë e Kosovës gjatë pandemisë së shkaktuar nga COVID-19 ka marrë vëmendjen e duhur të publikut, një pjesë më pak e diskutuar është ajo e humbjeve ekonomike të shkaktuara nga rënia e vizitave të diasporës në Kosovë, si pasojë e kufizimeve të ndryshme në udhëtime me qëllim të parandalimit të përhapjes së virusit COVID-19. Qëllimi i këtij studimi është që të bëjë një vlerësim të humbjeve ekonomike të shkaktuar nga kufizimet që ka hasur diaspora kosovare për realizimin e vizitave të tyre në Kosovë, si dhe të shihet se cili ka qenë ndikimi i pandemisë në trendin e IHD-ve dhe remitencave në përgjithësi.

Nga mesi i muajit mars 2020 deri në fillim të muajit qershor 2020, Kosova kishte paraqitur masa të ndryshme të kufizimit të udhëtimeve për qytetarë të huaj, duke përfshirë ndalimet e hyrjeve, mbylljen e pikave kufitare tokësore dhe ajrore, karantinimin dy javor dhe vetëizolim. Në anën tjetër, shumica e vendeve ku jeton diaspora e kanë futur Kosovën në listën e vendeve me rrezikshmëri të lartë. Në mënyrë që diaspora të realizonte vizitat e tyre në Kosovë, shumica e vendeve kanë kërkuar që të futeshin në karantinë me rastin e kthimit në vendet ku ata jetojnë. Kjo bëri që një pjesë e madhe e vizitave të zakonshme në Kosovë të anulohen apo të shkurtohen ditët e qëndrimit. Shkurtimi i qëndrimit të diasporës ka pasojë të dukshme në ekonominë e Kosovës dhe pritet t'i ndikojë negativisht sektorë të ndryshëm të ekonomisë duke filluar nga hoteleria, tregtia me pakicë, derivatet, gastronomia, etj. Varësisht nga skenarët e kalkuluar, shpenzimet nga vizitat e diasporës në vitin 2020 mund të jenë nga 0.55% të BPV-së (37 milionë euro) deri 1.83% të BPV-së (123 milionë euro), krahasuar me rreth 4.6% (328 milionë euro) sa është vlerësuar te këtë qenë para pandemisë, mirëpo kjo rënie pritet pjesërisht të kompenzohet nga rritja e remitencave përmes kanaleve zyrtare që kanë shënuar rritje gjatë pandemisë. Në vazhdim, format tjera të investimeve apo ndihmës të diasporës në Kosovë duket se kanë rënie. Investimet e huaja direkte në patundshmëri përbëjnë një pjesë të mirë të investimeve nga diaspora, ndërsa këtë vit këto investime kanë shënuar rënie të dukshme. Edhe dhurimi i gjësendeve nga diaspora për familjet e tyre duket të ketë shënuar rënie. Si shembull, veturat përbëjnë një ndër dhuratat kryesore që diaspora sjell për familjet e tyre dhe këtë vit importi i veturave ka shënuar rënie të theksuar.

Duke u bazuar në praktika të mira të vendeve tjera, në këtë studim ofrohen disa rekomandime se si mundet që kapitali financiar dhe njerëzor i diasporës të shfrytëzohet nga shteti i Kosovës me qëllim të rimëkëmbjes ekonomike. Shumica e diasporës janë të gatshëm të japin kontributin e tyre në Kosovë nëse ka një plan të qartë për kontributin e tyre dhe në rast të përmirësimit të ambientit të të bërit biznes. Për inkuadrim të kapitalit njerëzor të diasporës duhet së pari të krijohen databaza të mëdha të individëve me informata rreth aftësive të tyre dhe përvojave profesionale. Pas identifikimit duhet të krijohen rrjete profesionale dhe plane të qarta për inkuadrimin e tyre në ekonomi, veçanërisht në fusha ku mund të gjenerohet inovacion për tregjet lokale dhe ndërkombëtare.

* Ky raport analizon zhvillimin e ngjarjeve dhe të dhënat e qasshme deri në gusht 2020.

1. Hyrje

Me 11 mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) duke parë shpërndarjen alarmante, seriozitetin e sëmundjes së shkaktuar nga virus COVID-19 dhe mungesën e veprimeve nga vendet e ndryshme, e vlerësoi COVID-19 si një pandemi.¹ Duke marrë parasysh se pandemitë janë sëmundje infektuese të cilat shfaqen në mbarë botën, ose një hapësirë të madhe gjeografike që i tejkalon kufijtë shtetërorë dhe zakonisht i prek një numër të madh të njerëzve, COVID-19 ndikoi edhe në politikat e udhëtimit.² Qëllimi i këtij studimi është që të paraqesë kufizimet në udhëtime që ka vendosur Kosova dhe vendet ku jetojnë shumica e diasporës nga Kosova dhe të bëhet një matje e ndikimit ekonomik që kanë pengesat në lëvizjen e diasporës për vizitat e tyre në Kosovë, si dhe të analizohet trendi i remitencave dhe investimeve të huaja direkte të diasporës në ekonominë e vendit gjatë pandemisë së shkaktuar nga COVID-19.

Kufizimi i udhëtimeve, mbyllja e plotë e kufijve dhe karantinimi janë disa nga masat që janë ndërmarrë në shumë vende të botës si përgjigje ndaj parandalimit të pandemisë globale të virusit korona. Me datë 16 mars 2020, Komisioni Evropian krahas udhëzimeve për kontrollat brenda kufijve të BE-së, lëshoi udhëzimet për kufizimet e udhëtimeve ku i kërkohej shteteve anëtarë të refuzonin hyrjen e udhëtarëve nga vendet e treta, si Kosova, në vendet e BE-së.³ Kosova konsiderohet vend me rrezikshmëri të lartë të infeksionit nga shumë vende të Evropës, kështu që vendimet për masat e marra për qytetarët që vizitojnë Kosovën, po vështirësojnë dhe pengojnë edhe ardhjen e diasporës. Krahas këtyre kufizimeve, edhe Kosova mbylli kufijtë për gati tre muaj, nga data 13 mars deri me 31 maj 2020, duke vendosur masa të ndryshme kufizuese.

Të gjitha këto kufizime bënë që vizitat e diasporës së Kosovës të bien dukshëm. diaspora luan rol të rëndësishëm për ekonominë e Kosovës, jo vetëm për shkak të dërgimit të remitencave për familjet e tyre, por edhe pse gjatë vizitave të tyre ata shpenzojnë shuma të konsiderueshme të parave duke gjallëruar kështu aktivitetin ekonomik të shumë sektorëve, sikurse gastronomia, hoteleria, derivatet, dyqanet ushqimore, sallone ondulimi, etj. Rreth 3.8 milionë vizita apo pothuajse 75% e vizitave nga jashtë në Kosovë në vitin 2019, ishin për qëllime të vizitave të të afërmeve, që mund të konsiderohen kryesisht vizita nga diaspora.⁴

Për realizimin e këtij studimi janë përdorur të dhëna primare për numrin e udhëtarëve në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari” (ANP) dhe numrin e polisave kufitare të shitura në periudhën janar-gusht 2020. Gjithashtu, janë përdorur të dhëna sekondare të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), faqet zyrtare të internetit të ministrive të punëve të jashtme të vendeve ku jeton diaspora dhe studime tjera empirike. Përditësimi i të dhënave sa i përket politikave të udhëtimit ka përfunduar në fillim të muajit gusht 2020. Për shkak se Policia e Kosovës nuk ka mundur të ofrojë të dhëna, mangësi në realizimin e këtij studimi janë mungesa e të dhënave të detajuara lidhur me numrin e vizitave nga jashtë për arsye personale si dhe netët e qëndrimit të tyre.

1 WHO, Archive: WHO Timeline – COVID-19, Burimi: <https://bit.ly/2FTbRyv>

2 WHO, The classical definition of pandemic is not elusive, Burimi: <https://bit.ly/3mNoCJ9>

3 European Commission, COVID-19: Temporary Restriction on Non-Essential Travel to the EU, Burimi: <https://bit.ly/3mEfVUi>

4 ASK, Statistika e hotelierisë TM1 2020, Burimi: <https://bit.ly/3kNoRFh>

Ky studim është i organizuar si në vijim: në fillim janë paraqitur politikat e udhëtimeve gjatë pandemisë që ka pasur Kosova në raport me të huajt, politikat e vendeve ku jeton shumica e diasporës kosovare dhe rënia e të hyrave në ekonominë e Kosovës si pasojë e numrit të vogël së vizitave nga diaspora. Në pjesën tjetër është analizuar trendi i remitencave dhe ndikimi i diasporës në IHD-të gjatë pandemisë. Në pjesën e fundit janë paraqitur praktika të mira të nxitjes së remitencave për investime dhe përfshirjen e diasporës në zhvillimin ekonomik të vendit. Në fund janë dhënë përfundimet dhe rekomandimet.

2. Kufizimet e hyrjeve në Kosovë gjatë pandemisë COVID-19

Pas paraqitjes së rastit të parë me korona virus në Kosovë, me 13 mars 2020, Qeveria e Kosovës vendosi t'i mbyllte kufijtë tokësorë për udhëtarët që hyjnë në Kosovë, përveç për shtetasit e Kosovës që do t'u nënshtroheshin kontrolleve mjekësore dhe vetëizolimit për 14 ditë.⁵ Me këtë vendim të qeverisë u pezulluan të gjitha linjat e udhëtimit ajror në aeroportin e Prishtinës, përveç fluturimeve ushtarake, emergjencave mjekësore, dhe linjave të udhëtimit që shërbejnë vetëm për largim të udhëtarëve nga Kosova. Ky vendim u plotësua me një vendim tjetër ku përjashtim do të bënin edhe linjat e udhëtimit në ardhje me shtetas kosovarë që i'u pamundësua kthimi apo stafit diplomatik të akredituar.⁶ Me kërkesë të Ministrisë së Shëndetësisë, qeveria shpalli emergjencë të shëndetit publik,⁷ ku deri në pushimin e gjendjes emergjente të gjithë personat që janë vërtetuar ose dyshuar të kenë qenë në kontakt të drejtëpërdrejt me personat e sëmurë apo të dyshimtë me virusin korona janë futur në 'Qendrën e Studentëve' në Prishtinë të caktuar si hapësirë karantine.⁸

Dy muaj më vonë, situata epidemiologjike ishte konsideruar me rrezik të reduktuar dhe Ministria e Shëndetësisë paraqiti fazat e para të hapjes graduale. Më 30 maj 2020, u shfuqizua karantinimi dhe të gjitha vendimet që kanë rregulluar procedurat e karantinës. Personat e vendosur në këto hapësira (qendra e studentëve dhe qendra e të huajve Vranidoll) janë obliguar t'i nënshtrohen testit RC-PCR për Sars COV-2 dhe të njejtit janë liruar në vetëizolim për 14 ditët e ardhshme. Vetëizolimi ishte detyruar për të gjithë qytetarët që hyjnë në Republikën e Kosovës.⁹

Më 31 maj, Qeveria e Kosovës mori vendim të hapë kufijtë tokësorë në Merdar, Vërmice, Kullë, Hani i Elezit, Jarinjë dhe Dheu i Bardhë. Në vijim, të gjithë personat që kanë hyrë në Kosovë dhe nuk kanë poseduar testin RC-PCR për Sars COV-2 janë detyruar të vetëizolohen për 7 ditë.¹⁰ Pas rreth një jave me datë 7 qershor, Qeveria e re e Kosovës e votuar me 3 qershor, në mbledhjen e katërt mori vendim për largimin e vetë izolimit për qytetarët që hyjnë në Republikën e Kosovës.¹¹ Më datë 22 qershor u hapen edhe kufijtë tokësorë edhe për pikat: Qafë Prushë, Qafë Morinë, Muqibabë, Mutivodë, ndërsa me datë 28 qershor rifilloi hapja e transporti ajror dhe hapja e Aeroportit "Adem Jashari" në Prishtinë.¹²

5 Qeveria e Republikës së Kosovës, Vendimet e mbledhjes nr. 9, Burimi: <https://bit.ly/33yhoV5>

6 Qeveria e Republikës së Kosovës, Vendimet e mbledhjes nr. 12, Burimi: <https://bit.ly/2XDgrH4>

7 Qeveria e Republikës së Kosovës, Vendimet e mbledhjes nr. 11, Burimi: <https://bit.ly/3aoxTKM>

8 Qeveria e Republikës së Kosovës, Vendimet e mbledhjes nr. 13, Burimi: <https://bit.ly/3gzDOsM>

9 Qeveria e Republikës së Kosovës, Vendimet e mbledhjes nr. 35, Burimi: <https://bit.ly/344HLSV>

10 Qeveria e Republikës së Kosovës, Vendimet e mbledhjes nr. 38, Burimi: <https://bit.ly/3a7xRAH>

11 Qeveria e Republikës së Kosovës, Vendimet e mbledhjes nr. 4, Burimi: <https://bit.ly/2DIY3W8>

12 Qeveria e Republikës së Kosovës, Vendimet e mbledhjes nr. 5, Burimi: <https://bit.ly/3klfehC>

Pas rritjes së rasteve të prekuara me COVID-19 në Kosovë, Qeveria e Kosovës mori masa të reja. Duke parë edhe situatën epidemiologjike të përkeqësuar në Maqedoni të Veriut dhe Malin e Zi, më 13 korrik, Qeveria e Kosovës mori vendim që të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi dhe Bosnje e Hercegovinës, që hyjnë në territorin e Republikës së Kosovës të posedojnë testin negativ RT-PCR në Sars COV-2, jo më të vjetër se 72 orë.¹³ Pas rritjes së vazhdueshme të infeksioneve, që nga 30 korriku, Qeveria e Kosovës ka vendosur që edhe qytetarët e Shqipërisë dhe të Serbisë të dëshmojnë se nuk janë të infektuar me COVID-19 dhe të paraqesin testin RT-PCR në Sars COV-2.¹⁴ Më 14 gusht u hapën edhe pikat e kalimit kufitar me Shqipërinë në Shishtavece, Orqush, Borje, pikat e kalimit të kufirit me Maqedoninë e Veriut në Gllloboqicë dhe Stanqiq, dhe pika e kalimit kufitar me Serbinë në Bërnjak.¹⁵

Kronologji e ngjarjeve

- 11 mars** ○ Pezullohen përkohësisht linjat tokësore dhe ajrore nga vendet me rrezik të mesëm dhe të lartë
- 13 mars** ○ Mbyllen kufijtë tokësorë përveç për shtetasit kosovar që hyjnë në Republikën e Kosovës dhe obligohen të vetëizolohen për 14 ditë; pezullohen të gjitha linjat e udhëtimit ajror nga data 16 mars, përveç fluturimeve ushtarake, emergjencave medicinale dhe largimit të udhëtarëve nga Kosova
- 17 mars** ○ Lirohen linjat e udhëtimit ajror me ardhje të shtetasve kosovar dhe stafit diplomatik të akredituar që iu pamundësua kthimi për shkak të vendimit të datës 13 mars për udhëtimet ajrore
- 18 mars** ○ Caktohet hapësira e karantinimit në Qendrën e Studentëve në Prishtinë
- 30 maj** ○ Largohet karantinimi dhe obligohet vetëizolimi 14 ditor për të gjithë personat që hyjnë në territorin e Kosovës
- 31 maj** ○ Hapen kufijtë tokësorë në: Merdarë, Vërmicë, Kullë, Hani i Elezit, Jarinjë dhe Dheu i Bardhë; personat që nuk e kanë rezultatin negativ në testin RT-PCR për Sars COV-2 detyrohen të vetëizolohen për 7 ditë
- 7 qershor** ○ Shfuqizohen vendimet për procedurat e vetëizolimit dhe posedimit të testit
- 22 qershor** ○ Hapen kufijtë tokësor në pikat e kalimit të kufirit: Qafë Prush, Qafë Morinë, Muqibabë, Mutivodë
- 28 qershor** ○ Rifillon transporti ajror dhe hapet aeroporti “Adem Jashari” në Prishtinë
- 13 korrik** ○ Qytetarët e Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi dhe Bosnje Hercegovinës, që hyjnë në territorin e Kosovës duhet të dëshmojnë rezultatin negativ në testin RT-PCR në Sars COV-2
- 30 korrik** ○ Qytetarët e Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi, Serbisë dhe Bosnje Hercegovinës, që hyjnë në territorin e Kosovës duhet të dëshmojnë rezultatin negativ në testin RT-PCR në Sars COV-2.

13 Qeveria e Republikës së Kosovës, Vendimet e mbledhjes nr. 13, Burimi: <https://bit.ly/2EQcHvl>

14 Qeveria e Republikës së Kosovës, Vendimet e mbledhjes nr. 17, Burimi: <https://bit.ly/3fDKjly>

15 Qeveria e Republikës së Kosovës, Vendimet e mbledhjes nr. 24, Burimi: <https://bit.ly/2F9qz2g>

3. Kufizimet e lëvizjes ndër-shetërore të vendosura nga vendet ku jeton shumica e diasporës kosovare

Kufizimet e lëvizjes brenda shtetit sikurse edhe ato ndër-shtetërore ishin karakteristikë e përbashkët e masave të hershme të Kosovës si dhe shumë shteteve tjera kundër pandemisë. Duke marrë parasysh se ekonomia e Kosovës përfiton nga sektori i turizmit, e në veçanti nga kthimi i përkohshëm i diasporës, masat kufizuese që ende zbatohen ndaj udhëtimeve në apo nga Kosova padyshim se do të ndikojnë në të hyrat nga diaspora.

Në fillim të muajit mars të këtij viti, kur gjendja epidemiologjike në Evropë nuk kishte eskaluar ende, shumë shtete fillimisht ishin kundër idesë së mbylljes së kufijve. Bashkimi Evropian rekomandonte shtetet anëtare të kenë kujdes më të shtuar gjatë hyrjeve dhe daljeve nga ato shtete, mirëpo jo izolim total.¹⁶ Pas datës 15 mars, numri i infektiveve filloi të rritej dhe disa shtete të BE-së sikurse Danimarka, Spanja apo Polonia vendosën të mbyllin kufijtë për udhëtarët e huaj. Në anën tjetër, shtete si Gjermania, Austria apo Sllovenia fillimisht vetëm rritën kontrollin kufitar, por pas një kohe të caktuar gjithashtu mbyllën kufijtë. Gjatë asaj kohe, tranziti ishte i lejuar si masë pro-ekonomisë si dhe udhëtimet nga kategori të caktuara individësh me qëllime të rëndësishme udhëtimi siç janë: zyrtarë mjekësor, punëtorë sezonal, punëtorë transporti, diplomatë, familjarë të shtetasve evropian, udhëtarë me leje qëndrimi apo shtetësi në ndonjë shtet të BE-së, etj.¹⁷ Masat kufizuese rezultuan në një valë kritikash nga zyrtarë të shteteve të ndryshme sikurse Suedia dhe vetë presidenca e BE-së duke përmendur që bllokadat kufitare nuk janë në frymë të vlerave evropiane dhe mund të kenë edhe ndikime negative në furnizim të shteteve me mallra gjatë asaj kohe.¹⁸

Kufizimet e shteteve të BE-së vazhduan të jenë në fuqi deri më 15 qershor 2020, kur Komisioni Evropian rekomandoi që kufizimet e kufijve të brendshëm të lehtësoheshin dhe në vazhdimësi të lejoheshin edhe udhëtimet me qëllime jo të rëndësishme pas 30 qershorit. Megjithatë, jo të gjitha udhëtimet ishin të lejueshme. Komisioni Evropian rekomandoi që shtetet anëtare të përzgjedhin shtete të caktuara me rrezik më të ulët epidemiologjik, që do të rishikoheshin çdo dy javë, prej të cilave do të lejohej udhëtimi i lirshëm për në BE.¹⁹ Lista e shteteve me leje udhëtimi fillimisht përfshinte edhe Serbinë e Malin e Zi si shtete ballkanike, mirëpo dy javë më pas u tërhoqën nga lista për shkak se situata epidemiologjike në ato shtete u përkeqësua.²⁰ Në të njëjtën kohë, Kosova cilësohej si shtet me rrezik të lartë epidemiologjik dhe nuk u vu fare në listë.²¹

Megjithatë Komisioni Evropian rekomandoi që shtetet anëtare të marrin masa kufizuese të njëtrajtshme ndaj të huajve, shumë shtete evropiane (përfshirë Bashkimin Evropian dhe Zvicrën), të cilët njëkohësisht strehojnë një pjesë të madhe të diasporës kosovare, zbatonin masa të ndryshme sa i përket udhëtimeve në Kosovë dhe anasjelltas.

16 "Coronavirus: EU rules out Schengen border closures amid Italy outbreak," Deutsche Welle, 24.02.2020. Burimi: <https://bit.ly/2Q9OjHA>

17 Travel and transportation during the coronavirus pandemic, Komisioni Evropian. Burimi: <https://bit.ly/2Yju8vk>

18 "Nine EU states close border due to virus," Euobserver, 16.03.2020. Burimi: <https://bit.ly/2FDofm5>

19 "Coronavirus: Commission recommends partial and gradual lifting of travel restrictions to the EU after 30 June, based on common coordinated approach," Komisioni Evropian, 11.06.2020. Burimi: <https://bit.ly/31d6pyD>

20 "Council Updates List of Epidemiologically Safe Third-Countries – Removes Serbia & Montenegro," Schengenvisainfo, 16.06.2020. Burimi: <https://bit.ly/3hhNgG2>

21 Lista Gjermane e shteteve me rrezik të lartë epidemiologjik, Robert-Koch Institute. Burimi: <https://bit.ly/31bojyN>

Më 16 mars, **Gjermania**, shteti me diasporën më të madhe Kosovare, fillimisht ndaloi të gjitha hyrjet jo të rëndësishme brenda shtetit. Nga 15 qershori, Gjermania rihapi kufijtë me shtetet tjera evropiane edhe për udhëtime jo të rëndësishme,²² mirëpo në anën tjetër vazhdoi të ketë masa kufizuese për udhëtime të njejta nga shtete që cilësoi si me rrezik të lartë epidemiologjik sikurse Kosova.²³ Pra, udhëtarët me qëllim të rëndësishëm për udhëtim dhe pa dallime në nacionalitet, të cilët kanë qëndruar në Kosovë 14 ditë para udhëtimit në Gjermani, iu kërkohej testi RT-PCR. Në rast se testi ishte negativ, udhëtarët mund të lejoheshin në shtet pa vetë-izolim²⁴, por në raste pozitive duhej të vetë-izoloheshin për 14 ditë.²⁵ Problemi në raport me udhëtarët nga Kosova, ishte se Gjermania nuk i njihte rezultatet e asnjë laboratorit nga Kosova dhe praktikisht karantinimi ishte i pashmangshëm.²⁶ Megjithatë, që nga fillimi i gushtit, atyre udhëtarëve nuk iu kërkohej domosdo test paraprak ngase kishin mundësinë të testoheshin në aeroporte të Gjermanisë dhe në qendra mjekësore pa pagesë deri në tri ditë pas udhëtimit në Gjermani. Vetë-izolimi ende vlen për ata me rezultat pozitiv.²⁷

Zvicra gjithashtu përfshiu Kosovën në listën e shteteve me rrezik të lartë, mirëpo përkundër Gjermanisë zbatoi masa më të rrepta. Udhëtarët me qëllim udhëtimit të rëndësishëm, të cilët kishin qëndruar në Kosovë deri në 14 ditë para udhëtimit, iu kërkohej vetë-izolim 10 ditor pavarësisht rezultatit të testit RT-PCR.²⁸

Në **Itali** ka ndaluar hyrjet për udhëtarë të cilët nuk janë shtetas italian, evropian apo me leje qëndrimi në Itali. Tranziti lejohet me lëvizje totale të lejshme prej 36 orësh brenda Italisë, mirëpo udhëtarët e lartëpërmendur, të cilët kanë qëndruar në një zonë me rrezik të lartë epidemiologjik, duhet të iu nënshtrohen vetë-izolimit 14 ditor.²⁹

Sllovenia lejon udhëtarë me qëllim udhëtimit të rëndësishëm nga zona me rrezik të lartë epidemiologjik, ku bën pjesë edhe Kosova,³⁰ mirëpo kërkon 14 ditë vetë-izolim pavarësisht rezultatit të testit RT-PCR.³¹

Në anën tjetër, **Austria** ndalon udhëtime nga Kosova me qëllime të rëndësishme përveç tranzitit dhe atyre që kanë shtetësi apo leje qëndrimi austriake. Megjithatë, ata që mund të udhëtojnë duhet të vetë-izolohen në pamundësi të paraqitjes së rezultatit negativ të testit RT-PCR.³²

22 Rihapja e kufijve të Gjermanisë për udhëtarë të caktuar. 13.06.2020. Burimi: <https://bit.ly/3hrPwWL>

23 Lista Gjermane e shteteve me rrezik të lartë epidemiologjik, Robert-Koch Institute.

Burimi: <https://bit.ly/31bojyN>

24 Informata për udhëtim Gjermani, Zyra Federale për të Huaj, Gjermani, 03.08.2020.

Burimi: <https://bit.ly/2FzCt7u>

25 Informata për Koronavirus dhe udhëtime, Shteti i Berlin-it, Gjermani. Burimi: <https://bit.ly/3hcVPgQ>

26 Ambasada e Kosovës në Gjermani, Portim i dates 7 korrik 2020, Burimi: <https://bit.ly/3mOv05S>,

27 Informata për udhëtim Gjermani, Zusammen Gegen Corona, 05.08.2020. Burimi: <https://bit.ly/34fjgCi>

28 Informata për udhëtim Zvicër, Zyra Federale e Shëndetit Publik, Zvicër. Burimi: <https://bit.ly/2YhCCmq>

29 Informata për udhëtim Itali, Ministria e Shëndetësisë, Itali. Burimi: <https://bit.ly/3hfarsE>

30 Kosova në listën e vendeve me rrezik të lartë epidemiologjik sipas Qeverisë së Sllovenisë.

Burimi: <https://bit.ly/3aVVMUe>

31 Informata për udhëtim Slloveni, Ministria e Brendshme, Slloveni, 07.08.2020. Burimi:

<https://bit.ly/3iYpGKA>

32 Informata për udhëtim Austri, Ministria e Mirëqenies, Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Austri.

Burimi: <https://bit.ly/34nPDPC>

Suedia aplikon masa më të përgjithshme ndaj udhëtarëve me qëllime të rëndësishme, dhe andaj ndalon udhëtimet nga Kosova me përjashtim familjarëve të suedezeve dhe udhëtarëve me shtetësi apo leje qëndrimi suedeze.³³

Franca lejon tranzitin e pakufizuar, dhe udhëtarët me qëllime të rëndësishme, mirëpo kërkon vetë-izolim 14 ditor nga ata udhëtarë me simptoma të COVID-19 apo me rezultat pozitiv të testit RT-PCR. Gjithashtu, ka mundësi të kërkohet vetë-izolim edhe prej atyre me rezultat negativ. Kufizimet vlejné edhe për udhëtarë me leje qëndrimi apo shtetësi franceze që udhëtojnë nga Kosova.³⁴

Mbretëria e Bashkuar kërkon nga udhëtarët nga Kosova vetë-izolim 14 ditor.³⁵

Belgjika nuk lejon udhëtime në apo nga Kosova përveç atyre me qëllime të rëndësishme.³⁶ **Norvegjia** lejon udhëtime për familjarë të norvegjezve dhe udhëtarë me shtetësi apo leje qëndrimi norvegjeze. Megjithatë, edhe atyre iu kërkohet vetë-izolim prej 10 ditësh.³⁷

4. Rënia e të hyrave në ekonomi nga mos ardhja e diasporës në Kosovë

Rreth 64% e diasporës i bëjnë tri deri në katër vizita gjatë vitit në Kosovë. Kohëzgjatja e vizitave e 90% të diasporës është nga dy javë deri në një muaj. Sipas gjetjeve të ASK-së dhe UNDP-së në 2013, gjatë vizitave në Kosovë, një familje nga diaspora shpenzon rreth 2,715 euro në vit.³⁸ Para krizës, sipas një kalkulimi të përafërt të Insitutit GAP, shuma e shpenzuar gjatë vizitave të përvitshme në Kosovë nga diaspora ishte rreth 4.6% e BPV-së, ku në 2019 kjo shumë përlllogaritet të ketë qenë mbi 328 milionë euro.³⁹ Pjesa më poshtë, fokusohet në kalkulimin e një shifre të përafërt lidhur me shpenzimet e diasporës gjatë vizitave në Kosovë gjatë vitit 2020.

Gjatë pandemisë, për shkak të pasigurisë nga virusi korona, ndalesave të ndryshme dhe masave të karantinimit që kanë aplikuar shtetet nikoqire të diasporës, ardhja e diasporës në Kosovë ka qenë relativisht e vogël. Sipas të dhënave nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari” dhe Byroja Kosovare e Sigurimeve, në periudhën janar-gusht 2020, numri i vizitorëve në Kosovë ishte rreth 62.5% më i ulët se në vitin 2019. Vlen të theksohet se rreth 41% e diasporës preferon transportin ajror për të ardhur në Kosovë, ndërsa rreth 42% atë tokësor, kurse pjesa tjetër udhëton me autobus dhe të gjitha këto shpenzime paraqesin po ashtu një kosto të konsiderueshme për ta dhe njëkohësisht përfitime për kompani transportuese dhe të derivateve në Kosovë.⁴⁰

33 Informata për udhëtim Suedi, Policia Suedeze. Burimi: <https://bit.ly/31d8FpB>

34 Informata për udhëtim Francë, Ministria për Evropë dhe e Punëve të Jashtme. Burimi: <https://bit.ly/2Eggq5c>

35 Informata për udhëtim Mbretëri e Bashkuar, Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar.

Burimi: <https://bit.ly/2Yik8mo>

36 Informata për udhëtim Belgjikë, Zyra Federale për Shërbime Publike dhe Punë të Jashtme.

Burimi: <https://bit.ly/2YfPo6M>

37 Informata për udhëtim Norvegji, Direktori i Norvegjisë për Imigrim. Burimi: <https://bit.ly/3aFgUol>

38 Ministria e Diasporës. Rezultatet fillestare të regjistrimit të Diasporës. Burimi: <https://bit.ly/3hyNh3K>

39 Shih Tabelën 4 në Aneksin 1.

40 ASK dhe UNDP. Studimi mbi remitencat në Kosovë, 2012 dhe 2013. Burimi: <https://bit.ly/3m2qDDE>

Tabela 1. Numri i udhëtarëve në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari” (ANP), janar-gusht 2019 dhe 2020

	2019	2020
 Zvicër	595,456	239,308
 Gjermani	529,362	236,876
 Turqi	248,311	75,718
 Austri	71,614	36,742
 Mbretëri e Bashkuar	49,971	24,575
 Slloveni	35,119	
 Norvegji	25,457	6,416
 Belgjikë	21,144	9,132
 Hungari	20,565	5,366
 Itali	16,763	6,269
 Suedi	11,437	5,475
 Finlandë	8,582	
 Danimarkë	4,727	529
 Arabi Saudite	2,568	138
 Gjibraltari		132
 Poloni		47
Gjithsej	1,641,076	646,723

Burimi: Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës.

Shënim: Numri total nuk paraqet numrin e udhëtarëve të papërsëritur.

Tabela 2. Numri i policave kufitare të shitura në periudhën janar-gusht, 2019 dhe 2020

	Polica kufitare të shitura
Jan - Gusht 2019	307,948
Jan - Gusht 2020	113,380

Burimi: Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS)

Duke supozuar se trendi i vizitave do të jetë i njëjtë deri në fund të vitit dhe se kohëzgjatja e qëndrimit të diasporës për vizita në Kosovë është përgjysmuar krahasuar me vitet paraprake për shkak të pandemisë, dëmi i shkaktuar në të hyrat e ekonomisë së Kosovës nga mos ardhja e diasporës krahasuar me vitin 2019 pritet të jetë nga 205 deri në 291 milionë euro. Kalkulimi është bërë duke e përshtatur kalkulimin e ASK-së dhe UNDP-së të vitit 2013 mbi shpenzimet e diasporës gjatë vizitave në Kosovë për rritjen e produktivitetit dhe çmimeve në vendet nikoqire të diasporës ndër vite. Ndër të tjera, kalkulimet në tre skenarët e mëposhtëm ndërtohen edhe mbi supozimin se gjatë vizitave të tyre në Kosovë gjatë pandemisë, diaspora ka qëndruar për kohë të njëjtë (skenari 1), përgjysmë (skenari 2) dhe 70% kohë më pak (skenari 3) se në vitet e kaluara. Në dy skenarët e fundit, supozimet mbi kohëzgjatjen e qëndrimit të diasporës gjatë vizitave në 2020 ndërtohen bazuar në pasigurinë e diasporës nga virusi korona dhe frika për mbyllje të kufijve. Si rezultat, nga kjo del se në ekonominë e Kosovës nga ky burim i rëndësishëm i të ardhurave, pra shpenzimet që bën diaspora gjatë vizitave në Kosovë, në vitin 2020 pritet të futen mes 37 deri 123 milionë euro që paraqesin rreth 0.55 dhe 1.83% të BPV-së, respektivisht. Nëse marrim parasysh efektet multiplikatore dëmi del të jetë shumëfish më i madh.

Tabela 3. Rënia e të hyrave në ekonomi nga mos ardhja e diasporës në Kosovë në vitin 2020

	Skenari 1	Skenari 2	Skenari 3
Kohëzgjatja e qëndrimit të diasporës gjatë vizitave në Kosovë gjatë pandemisë	20 ditë (mesatare)	10 ditë (mesatare)	6 ditë (mesatare)
Vizitat e diasporës në Kosovë në 2020 krahasuar më 2019	-62.5%	-62.5%	-62.5%
Shpenzimet e Diasporës gjatë vizitave në Kosovë në 2020	123,020,717 € (1.83% e BPV)	61,510,358 € (0.92% e BPV)	36,906,215 € (0.55% e BPV)
Rënia në të hyra krahasuar me 2019	- 205,034,528 € (-63%)	-266,544,887 € (-81%)	-291,149,030 € (-89%)
Shpenzimet e diasporës në tri vitet e kaluara si shumë dhe si % e BPV-së	2017 309 milionë euro (4.8% e BPV-së)	2018 319 milionë euro (4.7% e BPV-së)	2019 328 milionë euro (4.6% e BPV-së)

Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e ANP, MF, OECD, ASK-UNDP dhe BKS

Një mënyrë tjetër se si diaspora i ndihmon familjarët në Kosovë është edhe përmes dhurimit të gjërave dhe shërbimeve për familjet e tyre si: roba, vetura, tokë, mobilje etj.⁴¹ Numri i veturave të importuara gjatë periudhës mars-gusht 2020, jep indikacion se kjo formë e ndihmës nga diaspora ka rënë gjatë pandemisë së shkaktuar nga COVID-19. Për këtë periudhë janë importuar rreth 4 mijë vetura më pak (30%) krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.⁴²


⁴¹ Ibid

⁴² Koha.net, Pandemia ul importin e veturave.

5. Remitencat e diasporës gjatë pandemisë

Në periudhën janar-gusht të vitit 2020, vlera e remitencave të dërguara në Kosovë nga diaspora ishte 608.5 milionë euro apo rreth 55.4 milionë euro (10%) më e lartë se në vitin 2019.⁴³ Ato mbesin më të lartat në Ballkanin Perëndimor dhe ishin rreth 12% të Bruto Produktit Vendor (BPV) të Kosovës para pandemisë së shkaktuar nga COVID-19.⁴⁴ Në rast se vazhdon trend i njejtë i rritjes gjatë këtij viti, një parashikim indikativ sugjeron se remitencat mund të arrijnë deri në 14% të BPV-së.⁴⁵ Marrë parasysh se këtë vit Kosova po kalon në një krizë shëndetësore dhe ekonomike, rritja e remitencave paraqet një zhvillim tejet pozitiv për ekonominë e Kosovës. Së pari, pasi që po ndihmohen shumë familje, ku disa nga të cilat mund të jenë prekur më rëndë nga pandemia COVID-19, qoftë duke humbur vendet e punës apo duke shpenzuar më shumë se herave të kaluara për shëndetësi. Po ashtu, marrë parasysh aktivitetin më të ulët ekonomik dhe mos intervenimin e duhur të qeverisë për të rritur konsumin⁴⁶, hyrja e parave të diasporës në treg, nëse marrim parasysh dhe efektin shumëzues, paraqet një ndikim shumë herë më të madh në ekonominë e Kosovës se në vitet e kaluara.

Figura 1. Remitencat në Kosovë, janar-gusht 2019 dhe 2020



Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e BQK

5.1 Faktorët që ndikojnë në lartësinë e remitencave

Në përcaktimin e faktorëve që ndikojnë në sjelljen e diasporës lidhur me dërgimin e parave tek të afërmit në Kosovë, rëndësi të veçantë kanë edhe luhatjet në ekonominë e vendit nikoqir të diasporës. Në kushte jo pandemike, sipas gjetjeve të një studimi empirik të kryer më 2018, rritja ekonomike në vendet ku jeton diaspora ndikon në rritjen e dërgesave në Kosovë. Ngjashëm, në rritjen e dërgesave ndikon edhe përkeqësimi i gjendjes ekonomike në Kosovë që tregon për altruizmin e diasporës karshi familjarëve të tyre.⁴⁷

⁴³ Banka Qendrore e Kosovës. Seritë Kohore. Burimi: <https://bit.ly/3l4dNEq>

⁴⁴ Banka Botërore. Pasiguritë në rritje. Burimi: <https://bit.ly/39xbvse>. Si dhe të dhënat e ASK dhe BQK.

⁴⁵ Një parashikim indikativ duke përdorur metodën e "Parashikimit sezonal të dyfishtë eksponencial" dhe "Parashikimin sezonal Holt-Winters". Shih Aneksin 2.

⁴⁶ Përveç Pakos Emergjente Fiskale që përbënte injektim të parashë në sektorët e prekur nga pandemia për muajt prill dhe maj, Kosova është ndër shtetet e vetme në rajon që nuk ka vazhduar mbështetjen e qytetarëve dhe bizneseve të afektuar nga pandemia gjatë periudhës qershor-gusht. Vonesa në implementimin e masave të reja të Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike, mund të rezultojë në mos arritje të efektshmërisë së dëshiruar të ndërhyrjeve (implementation lag).

⁴⁷ Esida Bujupi. Banka Qendrore e Kosovës. Përcaktuesit makroekonomikë të remitencave në Kosovë: Analizë

Modeli i Bujupi (2018) nuk merr në konsideratë skenarin se si ndryshon sjellja e diasporës lidhur me dërgimin e parave tek familjet në Kosovë në rast se aktiviteti ekonomik ka rënë në të njëjtën kohë në vendin nikoqir dhe në Kosovë, siç po ndodh tani për shkak të pandemisë. Mirëpo, të gjeturat nga studime tjera që konsiderojnë raste nga krizat e kaluara, gjejnë efekte të moderuara të rënies ekonomike në vendin nikoqir në lartësinë e remitencave të emigrantëve drejt vendeve të tyre të origjinës. Konkretisht, edhe në rastet kur ka rënie të remitencave në kohë krizash, ato nuk janë drastike dhe, në rastin e krizës globale 2008/'09, në disa vende, remitencat janë rikthyer në lartësinë e mëparshme në kohë relativisht të shkurtë. Në përgjithësi, literatura i cilëson remitencat si më stabile dhe më pak sensitive ndaj rënieve ekonomike.⁴⁸ Kryesisht vërehet një dominim i motivit altruist tek dërguesit e remitencave. Po ashtu, të dhënat deskriptive nga Banka Qendrore e Kosovës japin indikacion se edhe tek diaspora e Kosovës po mbizotëron motivi altruist, pra që të ndihmohen të afërmit në Kosovë në periudhën e vështirë të pandemisë COVID-19. Konkretisht, gjatë pandemisë është shënuar rritje e remitencave krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019, me ç'rast është arritur edhe vlera më e lartë e remitencave e dërguar ndonjëherë brenda një muaji në Kosovë, me mbi 104 milionë euro vetëm gjatë muajit maj 2020.⁴⁹ Kjo ka ndodhur edhe përkundër faktit që edhe ekonomia e vendeve nga ku vijnë kryesisht remitencat në Kosovë, Gjermania dhe Zvicra, është goditur ndjeshëm nga pandemia.⁵⁰ Gjithsesi, elemente të rëndësishme në këtë sjellje të diasporës karshi remitencave në kohë të pandemisë paraqesin shkalla e lartë e punësimit të tyre dhe shprehia për të kursyer rregullisht një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave mujore.⁵¹

Profili i familjeve pranuese të remitencave dhe diasporës

Për të dhënë propozime për implementim të politikave adekuate për destinimin e remitencave në burime që paraqesin kthim në investim, është e nevojshme të dihet struktura e familjeve pranuese të remitencave dhe qëllimet e përdorimit të remitencave nga ta. Bazuar në të gjeturat e një ankete të kryer nga UNDP në 2013, del se mbi 43% e familjeve në Kosovë kanë familjarë që jetojnë jashtë Kosovës dhe mbi 22% e tyre pranojnë remitenca gjatë vitit. Tek shpërndarja e përfituesve sipas zonave, vërehet një dominim i lehtë i vendbanimeve rurale. Sipas rajoneve, dominon rajoni i Pejës ku 37% e përfituesve janë nga kjo pjesë, pasuar nga Gjilani dhe Ferizaj me nga 26%, Prizreni me 23%, Mitrovica me 22% dhe Prishtina me 20%.⁵² Familjet që pranojnë rregullisht remitenca, rreth 48.3%, realizojnë të hyra mujore (duke përfshirë dhe remitencat) prej mesatarisht 724 Euro, për çka edhe niveli i shpenzimeve mujore i këtyre familjeve është më i lartë se i atyre që nuk pranojnë remitenca. Sipas anketës së UNDP të vitit 2012, familjet pranuese i shpenzojnë mbi 60% të remitencave në ushqim, veshmbathje, shërbime dhe paisje shtëpiake, rreth 20% për investime në patundshmëri dhe 10% për arsim dhe shërbime shëndetësore.⁵³ Këto të gjetura sugjerojnë se remitencat janë faktor i rëndësishëm edhe në zbutjen e varfërisë në Kosovë. Ndërsa, ndikimi në investime dhe arsim është më i ulët.

me të dhëna panel. Burimi: <https://bit.ly/3kJR8fw>

48 Shih Reister (2012), Lacalle (2012), Akkoyunlu (2012). Burimi: <https://bit.ly/36eThw7>. Po ashtu, shih Jha et al. (2009). Burimi: <https://bit.ly/3hYDuUj>.

49 Shih të dhënat e Bankës Qendrore të Kosovës tek Seritë Kohore. Burimi: <https://bit.ly/3l4dNEq>

50 Në një masë, ndikim në rritjen e remitencave ka edhe pamundësia e ardhjes së diasporës në pushim që në të kaluarën është shfrytëzuar edhe si kanal për sjelljen e remitencave tek familjet, e të cilat nuk janë përfshirë tek shifrat zyrtare të remitencave.

51 ASK dhe UNDP. Studimi mbi remitencat në Kosovë, 2012 dhe 2013. Burimi: <https://bit.ly/3m2qDDE>


52 ASK dhe UNDP. Studimi mbi remitencat në Kosovë, 2012 dhe 2013. Burimi: <https://bit.ly/3m2qDDE>

53 Ibid

Për të pasur një bazë për analizimin dhe ndërtimin e rasteve të ndryshme se si pandemia mund t'i ndikojë remitencat dhe Investimet e Huaja Direkte (IHD) në Kosovë, është e rëndësishme të dihet shpërndarja e diasporës nëpër shtete dhe statusi i punësimit të diasporës. Kështu që, varësisht edhe nga goditja ekonomike që e kanë pësuar shtetet nikoqire të diasporës dhe masat të cilat i kanë ndërmarrë lidhur me kufizimin e lëvizjes së qytetarëve mund të supozohet për dëmin ekonomik në Kosovë nga ulja e të hyrave nga burimet më lartë.

Bazuar në vlerësime të ndryshme, numri i emigrantëve kosovarë (diasporës) që jetojnë jashtë vendit është mbi 30% e popullsisë së Kosovës.⁵⁴ Shtetet kryesore në të cilat është e përqëndruar diaspora kosovare janë Gjermania me 37% të totalit të përgjithshëm, Zvicra me 30%, Italia me 5%, Suedia me 5%, Austria me 4% dhe Franca me 4%. Në vitin 2019, lartësia e dërgesave të remitencave sipas origjinës ishte thuajse në vijë me përqindjen e emigrantëve që jetojnë në ato vende. Konkretisht, rreth 41% e gjithë remitencave në vitin 2019 janë dërguar nga Gjermania ku jeton mbi 37% e diasporës. Po ashtu, siç tregon Figura 2, rreth 20% e remitencave e kanë origjinë Zvicrën.⁵⁵

Figura 2. Vendbanimi i diasporës së Kosovës dhe dërgesat sipas shteteve



Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Ministrisë së Diasporës dhe BQK

Tek diaspora, mbi 93% e kryefamiljarëve janë të punësuar⁵⁶ ndërsa në nivel të të gjithë anëtarëve të familjes punësimi është rreth 68%.⁵⁷ Mbi 63% e familjeve që dërgojnë remitenca në Kosovë realizojnë të hyra mujore nga 2000 deri 4000 Euro, ndërsa rreth 17% më të larta se 4000 euro.

54 Sipas vlerësimeve nga Banka Botërore dhe ASK.

55 Banka Qendrore e Kosovës. Seritë Kohore. Burimi: <https://bit.ly/3l4dNEq>

56 Ibid


57 Ministria e Diasporës. Rezultatet fillestare të regjistrimit të Diasporës. Burimi: <https://bit.ly/3hyNh3K>

6. Diaspora dhe Investimet e Huaja Direkte (IHD) në Kosovë

Një pjesë e madhe e investimeve në patundshmëri në Kosovë bëhen nga diaspora. Siç tregon edhe anketa e kryer nga UNDP, mbi 35% e diasporës janë përgjigjur se investojnë në Kosovë, kryesisht në blerjen e patundshmërive për përdorim personal (60%) dhe investim në biznese familjare (23%).⁵⁸

Gjatë dhjetë viteve të fundit, Investimet e Huaja Direkte në Kosovë kanë pësuar luhatje dhe nuk kanë qenë të qëndrueshme. Nga mbi 384 milionë euro në 2011, ato kishin rënë në 116 milionë në 2012. Ngjashëm pas një rritjeje në 190 milionë në 2015, IHD-të përsëri pësuan rënie në rreth 168 milionë euro në vitin 2017. Në vitin 2019, vlera e IHD-ve ishte rreth 271 milionë euro.⁵⁹ Nga viti 2012, sektori i patundshmërive mbetet sektor dominues, me rritje të madhe krahasuar me sektorët tjerë, ku në vitin 2019 ajo përbënte rreth 87.5% të të gjithë IHD-ve. Ndërtimi dhe shërbimet tregtare dhe financiare kryesisht përbëjnë burimet tjera të IHD-ve.

Figura 3. Trendi i IHD-ve në Kosovë sipas sektorëve, 2010-2019




Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e BQK

⁵⁸ ASK dhe UNDP. Studimi mbi remitencat në Kosovë, 2012 dhe 2013. Burimi: <https://bit.ly/3m2qDDE>

⁵⁹ Banka Qendrore e Kosovës. Seritë Kohore. Burimi: <https://bit.ly/3l4dNEq>

Për dallim nga vitet e kaluara, në periudhën e pandemisë (2020), të hyrat nga IHD-të kanë rënë. Sektori i më i goditur është pikërisht ai i patundshmërive i cili në dy vitet e kaluara në periudhën mars-qershor kishte bilanc pozitiv prej mbi 70 milionë eurove, ndërsa në 2020 ka rënë në 42 milionë euro apo një rënie prej 40%. Krahasuar vetëm me 2019, bilanci i përgjithshëm i IHD-ve, gjatë pandemisë në vitin 2020, është më i lartë për afro 16 milionë euro apo 27% kryesisht për shkak të rrijtes së kategorisë së shërbimeve financiare. Ndërsa sektorët tjerë kanë pësuar luhatje të cilat u ngjasojnë atyre të viteve të mëhershme.

Figura 4. IHD në Kosovë në periudhën mars-qershor, 2018-2020



Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e BQK

7. Politika që nxisin shfrytëzimin e qëndrueshëm të kapitalit financiar dhe njerëzor të diasporës për zhvillim ekonomik

7.1 Shfrytëzim i qëndrueshëm i kapitalit financiar të diasporës

Duke qenë të hyra të rregullta edhe gjatë pandemisë, remitencat janë vitale për familjet pranuese në Kosovë për të përballuar krizën e shkaktuar nga virusi korona. Marrë parasysh se shumë nga këto familje mund të kenë mbetur pa asnjë anëtar të punësuar në këtë periudhë, tani remitencat mbesin të hyrat kryesore të tyre. Mbi 60% të remitencave, familjet pranuese, të cilat deri para pandemisë kryesisht kanë pasur edhe të hyra tjera mujore, i shpenzojnë në ushqim dhe gjëra shtëpiake. Vetëm rreth 20% e remitencave të pranuar shfrytëzohet për qëllime të investimit dhe atë kryesisht në patundshmëri. Në anën tjetër, vetëm 35% e diasporës pohojnë të kenë investuar në Kosovë dhe mbi 20% pohojnë të ruajnë kursimet e tyre në banka në Kosovë.⁶⁰

Marrë parasysh situatën e krijuar aktualisht nga pandemia, ku nuk dihet kohëzgjatja e saj dhe si rrjedhojë as dëmi që do të mund ta shkaktojë në ekonomi, është koha që Qeveria e Kosovës t'i trajtojë remitencat si burim që mund të pësojnë luhatje dhe kështu të mendojë për politika që nxisin përdorimin e tyre në burime që sjellin kthim në investim. Shtetet tjera, duke u ballafaquar me situatë të ngjashme, kanë ndërmarrë politika që synojnë ridestinimin e remitencave drejt investimeve dhe kursimit. Shtete fqinje, sikurse Maqedonia, kanë ndihmuar në funksionimin e platformave investuese të destinuara për diasporën që kanë funksionuar në vendet tjera, ku emigrantët bashkëinvestojnë në biznese me potencial përmes një skeme të mirë rregulluar.⁶¹ Disa shtete tjera kanë krijuar skema dhe programe që synojnë edukimin financiar të familjeve pranuese apo duke u mundësuar atyre blejre të pronave që financohen nga kursimi i remitencave.

Po ashtu, si formë për investim është përdorur edhe emitimi i obligacioneve qeveritare vetëm për diasporën, me ç'rast janë rritur dhe burimet e financimit për vetë qeverinë.⁶²

Kostoja e një transferi të remitencave nga Gjermania në Kosovë mesatarisht është rreth 5% e transferit.⁶³ Për të lehtësuar procesin e transferit të remitencave dhe nxitur dërgimin e tyre, shtetet kanë përdorur edhe mekanizma për uljen e kostos së transferit të remitencave si përdorimi i teknologjisë së telefonisë mobile apo nënshkrimi i marrëveshjeve bilaterale për korridore të transfereve.⁶⁴ Qeveria e Kosovës, gjatë vitit 2020, do të paguajë shpenzimet për sigurimin e veturave të diasporës që e viziton Kosovën, mirëpo nuk ka ndërmarrë ndonjë hap për nxitjen e transferit të remitencave.⁶⁵

60 ASK dhe UNDP. Studimi mbi remitencat në Kosovë, 2012 dhe 2013. Burimi: <https://bit.ly/3m2qDDE>

61 Shih platformen globale Homestrang.

62 UNDP. Development Finance Assessment. Burimi: <https://bit.ly/31k5pZx>

63 The World Bank, Remittance Prices. Burimi: <https://bit.ly/31rCwLh>

64 UNDP, Integrated Financing Solutions: Burimi: <https://bit.ly/2Yzi8Wz>

65 Telegrafi.com, Qeveria mbulon shpenzimet e kartonit të gjelbërt për bashkatdhetarët deri në fund të këtij viti, Burimi: <https://bit.ly/3lkl1Av>

7.2 Shfrytëzimi i kapitalit njerëzor të diasporës

Edhe pse diaspora e Kosovës vlerësohet jo-zyrtarisht të jetë rreth 800 mijë njerëz, potenciali i përfshirjes së diasporës në zhvillim ekonomik të vendit përtej remitencave është kryesisht ende i pashfrytëzuar.⁶⁶ Përveç ndihmave financiare nga diaspora, të cilat stimulojnë konsumin në Kosovë, aftësitë dhe përvojat e fituara nga bashkëatdhetarët gjatë qëndrimit të tyre jashtë vendit përfaqësojnë një sërë mundësish për zhvillim. Transferimi i atyre aftësive gjithashtu do të zbuste efektet negative të emigrimit të të rinjve kosovarë.

Një studim mbi diasporën shqiptare, gjen që 76% e bashkëatdhetarëve profesionistë të anketuar janë të gatshëm të ofrojnë kontributin e tyre në vendin e origjinës, qoftë në mënyrë fizike duke vizituar vendin herë pas herë apo në mënyrë virtuale. Megjithatë, të anketuarit pohuan që kontributin që do ta jepnin në vendin e origjinës duhet të bazohet në punë me kushte dhe qëllime të qarta, si dhe me fleksibilitet ngase jetën e tyre e zhvillojnë jashtë vendit.⁶⁷

Përveç remitencave apo ndihmave tjera financiare, Kosova mund të përfitojë nga potenciali i diasporës edhe përmes transferit të aftësive. Shtetet me diasporë të madhe si Kosova, kanë arritur që të shfrytëzojnë këtë potencial duke krijuar baza të mëdha të kontakteve me individë të interesuar në kontributdhënie. Shteti i Irlandës ka zhvilluar një aplikacion të quajtur “Global Skills Locator”, që ka për qëllim gjetjen e diasporës irlandeze me aftësi të caktuara që kërkohen në shtetin e Irlandës.⁶⁸ Meqenëse bashkëpunimi me akterë ndërkombëtarë mbi gjetjen dhe transferimin e diasporës kërkon kohë dhe resurse të mjaftueshme, përdorimi i teknologjisë zakonisht lehtëson procesin e përputhjes së nevojave të shtetit dhe diasporës me aftësi. Kosova është në proces të regjistrimit të diasporës dhe ky proces planfikohet të përfundohet në vitin 2021. Megjithëse ka progres në regjistrim, procesi ka ngecje dhe nuk janë arritur rezultatet e pritura.⁶⁹

Pas formimit të një baze të dhënash profesionistësh me interesim në kontributdhënie, praktikat e vendeve tjera tregojnë se edhe rrjetëzimi është faktor me rëndësi. Shtetet fqinje kanë organizuar takime të ndryshme jo-formale me bashkëatdhetarë në qytetet e tyre të origjinës me qëllim të njohjes më të mirë të gjendjes në vendlindje dhe se si ata profesionistë mund të ndihmojnë.⁷⁰ Rrjetëzimi mes diasporës dhe vendasëve mund të rezultojnë edhe në themelimin e partnerëve të rinj tregtarë që do të mund të përforconte pozitën e Kosovës në tregje ndërkombëtare.⁷¹

Përveç masave direkte që kanë të bëjnë me diasporën, përvojat e vendeve tjera tregojnë se edhe përmirësimi i ambientit të të bërit biznes lehtëson investimet nga diaspora në projekte të ndryshme.⁷² Niveli i korrupsionit, transparencës, dhe përforsimi i të drejtave të pronësisë intelektuale janë faktorë me rëndësi në përcaktimin e investimeve nga diaspora e sidomos në sektorin e inovacionit që do të përfitonte nga përvoja dhe idetë unike nga diaspora.⁷³ Kosova është në fazë të hershme të luftimit të korrupsionit dhe ka pengesa në zbatimin e të drejtës intelektuale.⁷⁴

66 “Angazhimi i Profesionistëve Shqiptar nga Diaspora në Vendet e Origjinës,” faqe 5, Germin, Korrik 2020. Burimi: <https://bit.ly/3lpTlyb>

67 Ibid., faqe 34.

68 “Me fat si Irlandezët – si mund të jetë emigrimi një e mirë për Ballkanin Perëndimor,” faqe 10, Këshilli Evropian për Marrëdhënie Ndërkombëtare, Mars 2019. Burimi: <https://bit.ly/2EyHVax>

69 Ministria e Diasporës, Rezultatet preliminare të regjistrimit të diasporës, Burimi: <https://bit.ly/2FdRE6y>

70 “Me fat si Irlandezët – si mund të jetë emigrimi një e mirë për Ballkanin Perëndimor,” faqe 15, Këshilli Evropian për Marrëdhënie Ndërkombëtare, Mars 2019. Burimi: <https://bit.ly/2EyHVax>

71 Kathleen Neëland, Sonia Plaza, “What We Know About Diasporas and Economic Development,” Migration Policy Institute, Shtator 2013. Burimi: <https://bit.ly/31ADmWo>

72 “Me fat si Irlandezët – si mund të jetë emigrimi një e mirë për Ballkanin Perëndimor,” faqe 13, Këshilli Evropian për Marrëdhënie Ndërkombëtare, Mars 2019. Burimi: <https://bit.ly/2EyHVax>

73 Alireza Naghavi, Chiara Strozzi, “Sparking off the magic of diasporas,” VoxEU, Nëntor 2012. Burimi: <https://bit.ly/2G6nu5l>

74 EU Comission, Kosovo Country Report 2020, Burimi: <https://bit.ly/36GryVb>

8. Përfundime dhe rekomandime

Vizitat të cilat i bënë zakonisht diaspora tek familjarët e tyre në Kosovë, janë burim i rëndësishëm i të hyrave për ekonominë e Kosovës. Por, për shkak të pandemisë COVID-19, ardhja e diasporës në Kosovë gjatë vitit 2020 është në nivel të ulët. Përveç frikës nga virusi korona, pengesë për ardhjen e diasporës gjatë verës ishin edhe masat e ndërmarra nga Kosova dhe shtetet tjera për qytetarët që e vizitojnë Kosovën. Rritja drastike e numrit të të infektuarve para sezonës së verës bëri që shumë shtete në Evropë ta kualifikojnë Kosovën si një ndër vendet me rrezikshmëri të lartë të përhapjes së infeksionit.

Përveç remitencave të cilat kanë shënuar rritje gjatë pandemisë, rënie vërehet në investimet e diasporës në patundshmëri në Kosovë, blerje të gjësendeve për familjarët, dhe çfarë është më me ndikim për ekonominë tonë, është ulur ndjeshëm burimi i të hyrave nga shpenzimet që bënë diaspora gjatë vizitave në Kosovë. Para pandemisë, shpenzimet e diasporës gjatë vizitave llogaritej të kapnin vlerën mbi 328 milionë euro apo 4.6% të BPV-së në vit. Ndërsa këtë vit, bazuar në rënien drastike të vizitave të diasporës në Kosovë, për mbi 62.5% krahasuar me vitin 2019, përfitimi i ekonomisë së Kosovës pritet të jetë i vogël, rreth 0.55% të BPV-së (37 milionë euro) deri 1.83% të BPV-së (123 milionë euro).

Për ekonominë e Kosovës është shumë i rëndësishëm fakti që të hyrat nga remitencat nuk kanë rënë gjatë pandemisë, ku kjo sjellje e diasporës tregon se tek ta dominon motivi altruist, ndonëse edhe ekonomitë e shteteve ku ata jetojnë janë goditur nga pandemia. Por, duke e ditur se të hyrat nga remitencat mund të mos jenë stabile në vitet e ardhshme për shkak të tronditjeve të ekonomive në nivel global dhe elementeve tjera, Kosova duhet:

- Të hartojë politika që nxisin ridestinimin e remitencave drejt investimeve dhe kursimit, qoftë duke krijuar platforma investuese apo emituar obligacione qeveritare për diasporën; duke ulur koston e transferit të remitencave; dhe, duke rritur programet mbi edukimin financiar të familjeve pranuese të remitencave;
- Të finalizohet regjistri i diasporës, me qëllim të shfrytëzimit të kapitalit njerëzor të diasporës, i cili duhet të përmbajë fushat e tyre të punës, përvojën profesionale, gatishmërinë për zhvendosje të përkohshme etj;
- Të punohet në krijimin e rrjeteve profesionale dhe planeve me qëllime konkrete për inkuadrimin e diasporës në ekonomi;
- Të punohet në përmirësimin e ambientit të biznesit me theks në forcimin e sundimit të ligjit, të drejtave të pronësisë intelektuale dhe transparencës.

9. Anekset

Aneks 1. Shpenzimet e diasporës gjatë vizitave në Kosovë (në Euro)


	Rritja nominale e BPV-së në BE-17	Shpenzimet e diasporës gjatë vizitave në Kosovë	BPV e Kosovës	Shpenzimet e diasporës si % e BPV-së të Kosovës
2012*	-	270,100,000 €	5,058,763,000	5.30%
2013	1.013	273,611,300 €	5,326,617,000	5.10%
2014	1.024	280,123,249 €	5,567,494,000	5.00%
2015	1.034	289,619,427 €	5,807,009,000	5.00%
2016	1.028	297,583,961 €	6,070,110,000	4.90%
2017	1.037	308,594,568 €	6,413,860,000	4.80%
2018	1.032	318,593,032 €	6,725,910,000	4.70%
2019	1.030	328,055,245 €	7,123,100,000	4.60%

Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e UNDP, OECD dhe ASK.

*Shënim: Për vitin 2012 për shpenzimet e diasporës është përdorur llogaritja e bërë nga UNDP.

Burimi: <https://bit.ly/3m2qDDE>

Aneks 2. Trendi i remitencave dhe parashikimi indikativ për vitin 2020



1. Metoda e Dyfishtë Eksponenciale

```
. tssmooth dexponential dexremit = remit, forecast(5)
computing optimal double-exponential coefficient (0,1)

optimal double-exponential coefficient =          0.0214
sum-of-squared residuals                =          .43852448
root mean squared error                  =          .074504649
```

2 Metoda sezonale e Holt-Winters

```
. tssmooth shwinters shwr = remit, forecast(5)
computing optimal weights

Iteration 0:   penalized RSS =  -.2956562   (not concave)
Iteration 1:   penalized RSS =  -.20243249  (not concave)
Iteration 2:   penalized RSS =  -.19660666  (not concave)
Iteration 3:   penalized RSS =  -.18052331
Iteration 4:   penalized RSS =  -.17566419
Iteration 5:   penalized RSS =  -.17463936  (not concave)
Iteration 6:   penalized RSS =  -.17438364  (not concave)
Iteration 7:   penalized RSS =  -.17423232
Iteration 8:   penalized RSS =  -.17411075  (not concave)
Iteration 9:   penalized RSS =  -.17405387
Iteration 10:  penalized RSS =  -.17404869
Iteration 11:  penalized RSS =  -.17404718
Iteration 12:  penalized RSS =  -.17404675
Iteration 13:  penalized RSS =  -.17404664
```

Optimal weights:

```
alpha = 0.0041
beta = 1.0000
gamma = 0.4303
penalized sum-of-squared residuals = .1740466
sum-of-squared residuals = .1740466
root mean squared error = .0469374
```


Instituti GAP është një think-tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

www.institutigap.org

Rr. Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Nr.4, 10000 Prishtinë

Tel: +383 38 609 339

info@institutigap.org



Instituti GAP mbështetet nga:



**Rockefeller
Brothers Fund**

Philanthropy for an Interdependent World

